



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 28 SHKURT 2019 - VAZHDIM

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 28. FEBRUARA 2019. GODINE - NASTAVAK

SHKURT - FEBRUAR  
2019

## **Rendi i ditës**

### **I. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme:**

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
3. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
13. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
14. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,
15. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
16. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
17. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
18. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
19. Emërimi i 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgimi Kulturore,
20. Shkarkimi i një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare,
21. Zgjedhja e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
22. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
23. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,

24. Zgjedhja e një (1) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media,
25. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
26. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore,
27. Emërimi i kryesuesit dhe të një (1) anëtarit të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
28. Emërimi i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
29. Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,
30. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019,
31. Votimi i kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së GP të PSD-së,
32. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për (2) dy anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

## **II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 janar 2019:**

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,
2. Votimi i Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
3. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.
4. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,
5. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.
6. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,
7. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,
8. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
9. Votimi në parim i Projektligjit për peticione,
10. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
11. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
12. Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
13. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
14. Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.

## **III. Pika e papërfunduar nga seanca jashtëzakonshme, e mbajtur më 8 shkurt 2019:**

1. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.

## **Dnevni red**

### **I. Nedovršene tačke sa prethodnih sednica**

1. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.05/L-132 o vozilima,
2. Drugo glasanje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
3. Drugo razmatranje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Drugo razmatranje N/zakona o davanju na korišćenje i o razmeni Opštinske nepokretne imovine,
6. Drugo razmatranje N/zakona za izmenu i dopunu zakona br.05/L-090 o sponzorstvu u oblasti kulture, mladih i sporta,
7. Drugo razmatranje N/zakona za izmenu i dopunu zakona br.2003/24 o sportu i zakona br. 04/L-075 izmenjenog i dopunjenog zakonom br. 2003/24 o sportu,
8. Drugo razmatranje N/zakona za izmenu i dopunu zakona br.05/L-075 o prevenciji i sankciji nasilja i negativnih pojava na sportskim događajima,
9. Drugo razmatranje N/zakona o porezu na lične dohotke,
10. Drugo razmatranje N/zakona o porezu na prihode korporacija,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o statusu albanskih obrazovnih radnika Republike Kosovo od školske 1990-91 do 1998-99 godine,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o tužilački savet Kosova,
13. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za člana Nezavisnog nadzornog saveta civilne službe Kosova,
14. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017.godinu.,
15. Glasanje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
16. Glasanje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
17. Glasanje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
18. Glasanje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine,
19. Imenovanje 7 (sedam) članova u Kosovskom savetu za kulturno nasleđe,
20. Razrešenje jednog (1) člana Borda Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komuniciranja,
21. Izbor predsedavajućeg Odbora Kancelarije regulatora energije,
22. Izbor jednog (1) člana Odbora Radio Televizije Kosova,
23. Izbor jednog (1) člana Borda Radio Televizije Kosova,
24. Izbor jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije,
25. Izbor članova Odbora za besplatnu pravnu pomoć,
26. Imenovanje članova Komisije za državnu pomoć,

27. Imenovanje Predsedavajućeg i jednog (1) člana Odbora Kosovske Agencije za privatizaciju,
28. Imenovanje direktora i zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Agencije za upoređivanje i verifikaciju imovine,
29. Glasanje za formiranje Parlamentarne anketne komisije o stanju u PTK i Vala,
30. Razmatranje zahteva Fonda penzijske štednje Kosova za usvajanje godišnje takse za 2019. god,
31. Glasanje predsedavajućeg u Komisiji za nadgledanje Kosovske agencije za inteligenciju, na zahtev PG SDS-a,
32. Formiranje komisije Ad-hoc za izbor kandidata za dva (2) članove Odbora Radio-televizije Kosova.

## **II. Nedovršene tačke sa plenarne sednice, održane 30. 01. 2019. god.:**

1. Glasanje N/zakona o ratifikaciji za Dodatni Protokol 5 uz Sporazum o izmeni i pristupanju Centralno Evropskom Sporazumu o slobodnoj trgovini,
2. Glasanje odluke Predsednika Republike Kosova o vraćanju Zakona br. 06/L-043 o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama,
3. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo,
4. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
5. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza,
6. Glasanje u načelu Nacrta zakona o javnom prenosniku Kosova,
7. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br.02/L-88 o kulturno nasleđe,
8. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
9. Glasanje u načelu Nacrta zakona o peticijama,
10. Glasanje u načelu Nacrta zakona za zaštiti od buke,
11. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
12. Glasanje u načelu N/zakona o porezu na dodatu vrednost,
13. Glasanje u načelu N/zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova,
14. Glasanje u načelu N/zakona o lustraciji figura visokih službenika u Javnim Institucijama i izabranih.

## **III. Nedovršena tačka sa vanredne sednice, održane 08. 02. 2019. god.:**

1. Glasanje o preporukama od parlamentarne debate o slučaju seksualnog uznemiravanja i silovanja, nezakonitog abortusa maloletnice i institucionalnoj odgovornosti Vlade Kosova.

**Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I kisha lutur deputetët, të cilët janë në ambientet e Kuvendit, të futen në sallë, ose duhet të kemi një vendimmarrje.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me rendin e ditës.

77 deputetë janë në sallë.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2, 14 deri 21, 29 e 31 kanë përfunduar në seancat e mëparshme.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

***1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete***

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej katër amendamente.

Procedojmë me votimin e amendamentit të propozuar sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik.

Zonja Shqipe Pantina e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zonja Pantina!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket Projektligjit për automjetet, tashmë një kohë të gjatë po vjen disa herë në seanca për votim dhe nuk kalon.

Qëndrimi ynë si PSD është se ne nuk marrim pjesë në votim për këtë projektligj për të pamundësuar kalimin e tij, por në rast se ka vullnet, edhe nga propozuesi, ne jemi të gatshëm ta votojmë projektligjin nëse ai ndryshohet dhe u përshtatet standardeve të BE-së.

Pra, në vend që të kushtëzohet importimi i automjeteve me vjetërinë e tyre, ai të kushtëzohet me plotësimin e standardeve, siç është standardi i emetimit të gazeve Euro 4, gjë që këtë formë e kanë të rregulluara edhe vendet e rajonit, si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, e kështu me radhë.

Pra, ose ky ndryshim, ky amendamentim mund të bëhet tani në seancë dhe ne mund ta votojmë, ose të tërhiqet për procedim të mëtutjeshëm, pra të kalojë në leximin e tretë apo të shtyhet për më

vonë dhe komisioni të mbledhet edhe një herë dhe t'i shqyrtojë amendamentet. Përndryshe, ne nuk marrim pjesë në votim nëse hidhet në votim kështu siç është tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mërgim Lushtaku, fjala për ju!

MERGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetar!

Së pari, ne e dimë shumë mirë që edhe e kemi bërë një hulumtim përkatës për këtë projektligj dhe këtë nismë ligjore, Ligjin për automjete, ne besojmë që i plotëson të gjitha standardet e Bashkimit Evropian dhe direktivat e BE-së, po i kanë vënë edhe një kriter shtesë, përveç Euro dizel 4 për emetimin e gazeve, që është çdo kund standard evropian, gjithashtu i kanë vënë edhe një kriter tjetër shtesë, për arsye që të kemi të siguruar që veturat të jenë të standardeve më të mëdha, edhe vitet që janë nga 10 tash në 15 vjet.

Po besoj që janë të përfshira, zonja deputete, edhe standardet e Bashkimit Evropian, nuk e kemi vendosur vetëm vitin, por edhe standardet.

Gjithashtu sa për njoftimin edhe të gjithë deputetëve, unë kam folur edhe me ministrin e Mjedisit dhe ministrin e Infrastrukturës dhe do të vendoset një taksë ambientale, e cila jo vetëm në vetura që importohen do të kenë këtë standard Euro dizel 4, por do të kenë edhe veturat që qarkullojnë.

Kështu që ju ftoj të gjithëve të votoni këtë projektligj.

KRYETARI: Avdullah Hoti, le të bëhet gati Muharrem Nitaj.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, kolegë deputetë,

Po mendoj që po vazhdon praktika që ligjet e caktuara, të nxitura nga interesa të ngushta, klienteliste, po sillen në Kuvend, siç është Ligji për automjete. Mua më vjen keq që tash PSD-ja praktikisht është duke kërkuar pazarin e radhës për të votuar këtë ligj.

E kemi të qartë, ky ligj kërkon rritjen e viteve të importit të veturave të vjetra, që është i dëmshëm për ambientin. Kemi dhënë qëndrimin tonë, na vjen keq që ky ligj dhe plot ligje të tjera dhe vendime të tjera merren komplet mbi baza klienteliste.

Njësoj ka ndodhur në Qeveri me koncept-dokumente për lojëra të fatit, të cilin e kemi trajtuar një herë, akciza në duhan, vendimi i Qeverisë dhe mandej trajtimi në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe plot ligje të tjera.

Kemi edhe një ligj tjetër që sot është në seancë, gjithashtu është për interesa të caktuara, të ngushta. Unë mendoj që nuk është roli i deputetëve që të përfaqësojnë interesa klienteliste apo të

njerëzve të caktuar, po të marrin parasysh interesin publik kur propozojnë ligje dhe për qëndrimet që i mbajnë në Kuvend.

Grupi ynë parlamentar nuk merr pjesë në votimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Muharrem Nitaj!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë kam qenë kryetar i Grupit Punues që është marrë me amendamentimin e këtij ligji, po spekulohet bukur shumë me të.

Unë dua t'ju njoftoj se sot në Kosovë mbi 70% e veturave që janë në qarkullim janë më të vjetra se sa viti 2006.

Në fakt, ky ligj po provon që ata njerëz që nuk kanë mundësi të kenë vetura më të reja se sa viti 2006, t'u mundësojë një gjë të tillë.

Sigurisht që projektligji mund të ketë edhe probleme, po realisht kjo është situata aktuale dhe Kosova nuk është as Suedi, as Zvicër dhe unë besoj, për shembull, që do të duhej që ta kemi një mirëkuptim për qytetarët tanë dhe për mundësitë e tyre materiale, në mënyrë që të mos i kemi më tepër se 100 e sa mijë vetura që janë më të vjetra se sa 20 vjet e që qarkullojnë në rrugët e Kosovës. Kjo është e para.

Dhe, e dyta, me këtë ligj nuk eliminohet standardi Euro 4, përkundrazi është i përfshirë edhe standardi Euro 4, që është i zbatueshëm edhe në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Unë i lus kolegët që të jenë më konstruktivë, nuk është këtu fjala fare për interesa, edhe për biznese, të paktën unë nuk njoh të tilla dhe besoj që ligji që është propozuar është më i miri i mundshëm dhe për qëllim ka që ta përmirësojë pikërisht standardin e ajrit dhe në vend që të ngasim vetura që janë më të vjetra se 20 e sa vjet, të kalojmë në vetura pak më të reja.

Ky ligj nuk është pa afat, ka afatin e vet të skadencës dhe ndoshta ky duhet konsideruar si hapi i parë drejt përmirësimit dhe ngritjes së standardit të veturave që importohen. Ne do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sali Zyba, urdhëro!

SALI ZYBA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Lëvizja Vetëvendosje nuk do të votojë për këtë ligj, për faktin se ka dhënë disa arsye të deri më tash. Në vend se të nxirret në votim tash e të hedhet poshtë, po bëhet diskutim rreth këtij

ligji, kështu që edhe qëndrimi ynë është, kemi arsye të ndryshme, sepse kolegu që ka iniciuar këtë procedurë tha se kanë konsultuar ministrin dhe do të vihet një taksë. Taksa për qytetarët në vazhdimësi ka.

Ndërsa forma e këtij ligji do të duhej të vijë në diskutim përmes votimit të tretë, përmes formës në diskutim të grupeve të interesit.

Të keni parasysh për regjistrimin dhe për forma të tjera, sidomos kontrolli teknik, me këtë ligj, me këtë mënyrë qysh e kemi analizuar ne, do të thotë i mbyll disa prej bizneseve, përkundër ndotjes së ajrit nga mënyra qysh vjen me vjetërsinë e automjeteve.

Prandaj, edhe qëndrimi ynë është që nuk e votojmë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Unë nuk do ta hap diskutimin te deputetët.

Do të shkoj edhe te dy deputetë, në fakt, propozuesi është mirë të deklarohet a do ta tërheqë, për arsye se ka një propozim, grupet parlamentare, edhe një herë propozuesja e parë, e cila kërkoi, zonja Shqipe Pantina, edhe një herë po dëshiron ta përsëris kërkesën, pastaj si propozues, Mërgim, shprehe qëndrimin, në qoftë se shkojmë, atëherë shkojmë drejt amendamenteve, s'kemi çka e ngarkojmë situatën.

Urdhëro, zonja Shqipe Pantina!

SHQIPE PANTINA: Atëherë, kërkesa jonë është që të ndryshohet amendamenti dhe të hiqet viti i vjetërsisë, sepse nëse lihet kështu siç është, lë hapësirë edhe për keqinterpretim, por edhe për keqpërdorim.

Ligji duhet të bazohet vetëm në standardet, të cilat tashmë janë edhe standarde të miratuara në BE dhe të hiqen vitet e vjetërsisë, sepse edhe ashtu nuk e kryejnë funksionin për të cilin po kërkohet, pra që emetimi i gazeve të jetë i kontrolluar. Në rast se ka pajtueshmëri që kjo të ndryshohet, ne e votojmë, përndryshe prapë e përsëris, ne nuk marrim pjesë në votim për të mos mundësuar kalimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Janë tri grupe parlamentare, të cilat deklarohen se nuk marrin pjesë në votim. Mërgim, a do ta tërheqësh, a ta fusim në votim. Në qoftë se futemi në votim, pastaj janë qëndrime, qëndrime individuale pak vlejné pastaj. Urdhëro!

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe fillimisht nismën ligjore kur e kam bërë, e kam bërë vetëm me standard Euro 4 dizel, por meqenëse në komision ka pasur ndryshime dhe ka pasur një reflektim që të rriten kriteret për import, janë shtuar vitet, nga 10 deri në 15.

Kështu që unë propozoj si iniciator i kësaj nisme ligjore që të kthehet edhe një herë në komision dhe pastaj të vijë në lexim. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, propozuesi ka kërkuar të tërhiqet kjo pikë e rendit të ditës që t'u jepet mundësi grupeve parlamentare. Po e vendos në votim që ta kthejmë në komision të njëjtin projektligj prapë.

Të përgatitemi për votim. Jemi te votimi, kthimi në komision i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete. Votojmë tash!

Ju lutem, ndërprerje votimin, kërkoj falje!

Vetëm kthimi në komision i të njëjtit projektligj, edhe një herë, ky projektligj kthehet në komision për rishqyrtim, me propozim të propozuesit.

Urdhëro, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Është mirë që nëse kemi mundësi, të gjitha çështjet të shkojnë me një votim të përbashkët prej grupeve parlamentare. Propozimi për t'u kthyer në komision dhe pajtimi nga ana e iniciuesit të këtij plotësim-ndryshimi të ligjit, domethënë na çon deri te ajo që ne do ta kemi një frymë unifikuese dhe për ta kthyer në komision besoj që nuk ka nevojë të nxirret në votim, sepse po pajtohemi të gjithë që të kthehet në komision. Të kthehet në komision edhe një herë që të përmirësohen ato çështje për të cilat ka pengesa për t'u votuar ky ligj. Ky është mendimi im procedural.

KRYETARI: Faleminderit! Do të jem prapë i drejtpërdrejtë, unë jam interpretues i Rregullores, pastaj të njëjtën kohë nuk e bëj asnjëherë vetëm, edhe administratën e konsultoj. Duhet të dalë në votim, ju kisha lutur, mos nxirrni yrnëk, veç ta vonojmë seancën çdo pesë minuta. Shkojmë në votim, ju e votoni, kalon ose përndryshe duhet të futemi në votim të amendamenteve. Unë jam duke e vënë në votim kthimin në komision të këtij projektligji, voton seanca si të dojë, votojmë tash!

Edhe një herë votojmë për kthimin në komision, po, jo, ose abstenim. Votojmë tash!

Shkojmë në votim, rezultati është ky si është, vendimmarrja është ajo si e Kryesisë, shkojmë në votim të amendamenteve. Urdhëro, zonja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po edhe mënyra e votimit tani edhe një herë na tregon që deputetët dhe ata që kanë buxhetin e fortë nuk e kanë interes këtë ligj. Pra, është mirë të shihen kush i ka veturat me 00 dhe ky ligj po të kalonte, është në interes të qytetarëve, gjithnjë në harmonizim me standardet e BE-së.

Pra, po shihet edhe një herë, deputetët nuk e kanë problem, besa edhe shumë të tjerë se i kanë veturat shumë të mira. Pra, shikoni kujt po i bie për shtati, ky ligj nëse nuk amendamentohet, nëse nuk kalon, pra është në dëm të qytetarëve. Pra, u mundëson qytetarëve të blejnë veturat më të reja se sa këto që i kanë sot në Kosovë. Për interesin e atyre që e kanë buxhetin e fortë, pra është që të mos kalojë ky ligj dhe është shumë mirë ta dinë qytetarët se interesi i deputetëve është të mos kalojë, i shumicës që kanë vettura me kilometra 00, e që kanë 'xhipa' të zinj dhe qytetarët e ngratë që s'kanë buxhet të blejnë një veturë tjetër, por ky do t'ua mundësonte ta blejnë një veturë më të re. Pra, është mirë të shihet këtu, interesi i deputetëve thashë edhe një herë që kanë buxhet dhe për 2-3 muaj mund ta blejnë një veturë, e qytetarët nuk e kanë të njëjtën mundësi.

KRYETARI: Faleminderit! Po i ndalim diskutimet për faktin se po futemi në amendamente, pastaj diskutoni në amendamente.

Amendamenti 1. Zonja Hykmete, po të shoh që po reagon, urdhëro, fjalën! Fol veç për amendamentin numër 1, të lutem.

HYKMETE BAJRAMI: Jo, për amendamentin numër 1, kryetar, është reagim ndaj deputetes Teuta Haxhiu. Nëse me të vërtetë dëshirojmë të punojmë për interes të qytetarëve, ta prishim monopolin e homologimit që e kemi që 20 vjet në Republikën e Kosovës. Ministri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka bërë një Udhëzim Administrativ që i mundëson kompanisë, e cila ka monopolin në homologim edhe 20 vjet të tjera ose në pafundësi ta ketë. Ne e kemi ngritur këtë çështje, arsyeja pse nuk po votohet ky ligj është sepse po dyshojmë, dhe dyshimet i kemi të bazuara, duke marrë parasysh monopolin me homologim, që prapë do t'i jepet monopoli dikujt pikërisht në inspektimin e standardeve dhe diçka tjetër.

Mos, vallë, duke provuar që qytetarëve t'ua bëjmë jetën më të lirë, po ua bëjmë më të shtrenjtë. Ju e keni parë se çka po ndodh edhe në sektorët të tjerë, si në sektorin e energjisë, këtu nuk ka interesa të qytetarëve, këtu ka interesa të grupeve, ta prishim monopolin në homologim dhe tani po ulemi të gjitha partitë politike e po diskutojmë për ta hequr edhe kufizimin e vjetërsisë dhe për të vendosur standarde, mirëpo duke u siguruar që asnjë kompani private nuk do të ketë monopol për asgjë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, po ta ka përmendur emrin, replikë, zonja Haxhiu, por po humb koha e seancës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Kolegia ime ka qenë ministre, e ka pasur edhe ministrin e subjektit politik të LDK-së, nuk e ka ndalur këtë monopol, nuk keni bërë asnjë hap, domethënë ju ka konvnuar edhe atëherë, sot të konvenon edhe më shumë, sepse i ke mbi 2 mijë euro pagë në universitet dhe 2-3 mijë këtu në Kuvend, normalisht që e blen për një muaj ditë veturën. Prandaj, edhe një herë nuk e keni bërë as edhe një hap për t'i ndalë këto monopole, e nderuar kolege deputete, me ministrin tënd, të

subjektit tënd. Por edhe ju si ministre është mirë të tregoni çka keni bërë në këtë drejtim. Pra, edhe një herë, mos bëni marketing, po kjo është një lojë e ndytë, ngase me 1 muaj ditë pagë sa merrni të hyra, ju mund ta blini një veturë, kurse qytetarët nuk e kanë mundësinë.

Pra, të rregullohen të gjitha standardet në harmonizim me BE-në, të plotësohen a të ndryshohen ato, por thjesht ta kenë mundësinë qytetarët të blejnë vetura më të vjetra, pra se sa aktualisht i kanë sot në përdorim. Mos luani me ndjenjat e tyre, sepse nuk mund të maten qytetarët me buxhetin tuaj.

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Hykemetë! Po, por humbim shumë kohë.

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar, faleminderit që po ma jep fjalën.

Në kohën kur ka qeverisur Isa Mustafa dhe kur unë kam qenë pjesë e qeverisë, është kërkuar nga kryeministri që të largohet monopoli. Ministri Zharku që është prezent, ju lutem të kesh durim, e merr fjalën dhe fol, e ka analizuar kontratën, kontrata e monopolit e homologimit skadon, nëse nuk gabo, tash diku në prill të vitit 2019. Ministri Pal Lekaj e ka bërë një Udhëzim Administrativ, i cili thotë që kompania aktuale duhet t'i shfrytëzojë më shumë se 85% të kapaciteteve, në mënyrë që një tjetër të hyjë në treg për homologim.

Nuk kemi mundur, sepse dikush tjetër, e ata janë partneri juaj tjetër, është ministri Limaj që ia ka dhënë monopolin me kontratë. Ishim shkuar në arbitrazh, mirëpo tash po skadon...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! A futemi në seancë? Ju kisha lutur, për arsye se jeni duke e humbur konceptin.

Amendamenti 1. Atëherë, po e shoh Bilall Sherifin, Milaim, Shkumbin, Vjosa, Hykmete, e more fjalën, më vjen keq, më shumë s'mundem, bëj shkelje të rëndë. Bilall, fjala për ju, Bilall Sherifit, të lutem!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar! Mendoj që kjo nga një çështje për të cilën sot duhej të jepej përgjigje u shndërrua në përplasje elektorale, edhe pse zgjedhjet nuk duken afër, por të flasësh për një çështje që është vendosur para 10 vjetësh dhe të njëjtën çështje ta kesh pasur në dorë për tre vjet në Qeveri dhe të mos e kesh zgjidhur, është më shumë se hipokrizi.

Prandaj, le të përqendrohemi tek ajo çka sot dhe çka mund të bëhet sot e nesër, por jo çka është bërë para 10 vjetësh, sepse kur është bërë atëherë ka qenë koalicioni PDK-LDK. Pra, kjo mendon se duke mos qenë vetë në Qeveri, nuk mban përgjegjësi për trashëgiminë e LDK-së, si për të mirat, si për të këqijat e koalicionit 2010-2014 mbani përgjegjësi, të nderuar kolegë dhe

korrektësia është që nëse ka qenë gabim, përgjegjësia të merret për aq sa i takon edhe partisë suaj, por jo të apostrofohen emrat e përveçëm për vendime kolektive, sepse në fund të fundit, ai ka qenë vendim i Qeverisë, i propozuar nga një ministër, por vendim i Qeverisë. Prandaj, le të përqendrohemi në atë çka të bëjmë sot. Nëse nuk është mirë të mbeten monopole, le t'i ndryshojmë, është Qeveria, Kuvendi dhe mund të ecim përpara, por të mos fillojmë me përplasje elektorale, sepse nuk besoj, edhe përkundër që mund të keni marrë ofertë, dijeni që janë të rrejshme ato. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Bilall! Ia mundësove Hykmetes edhe 2 minuta replikë, e përmende ministren. Urdhëro, është përgjegjësi juaja, s'është imja.

HYKMETE BAJRAMI: Së pari, zoti Sherifi 2010-2014 kemi qenë në opozitë, edhe një herë ju shpjegova, monopolin e ka krijuar kryetari i partisë tënde. Kryetari i partisë tënde ka ardhur në pushtet për ta 'çkap' shtetin, ne kur kemi qenë në Qeveri kemi dashur ta heqim, po ka qenë një kontratë e formuluar në atë formë që kompania na kishte dërguar në arbitrazh, qysh e ka çuar Telekomin edhe kompanitë e tjera, sepse ju kur i keni nënshkruar këto kontrata, i keni betonuar mirë, sepse dihet për çka janë bërë. A po më kupton? Po tash skadon kontrata dhe mos manipuloni e të dilni këtu e të flisni që kinse ju jeni për interesa të qytetarëve, se besoni që secili qytetar ju njeh edhe juve, edhe AAK-në, edhe të gjithë të tjerët.

Shikoni çka keni bërë me akcizën, shikoni çka po bëni me 8 milionë e 200 mijë euro që keni ndarë prej rezervave shtetërore. I ndani një kompanie, thua se të tjerat nuk kanë të drejta në këtë shtet. Ju lutem, mos manipuloni, ju mos manipuloni!

KRYETARI: Faleminderit! Kundër-replikë, Bilall!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Së pari kërkoj falje për lapsusin, jo 2010-2014, por 2008-2010-2011, sepse po bash në atë kohë është vendosur për, megjithatë kam qenë i saktë në atë se në koalicionin PDK-LDK është marrë ai vendim. Pra, përgjegjësia është e përbashkët e koalicionit, dhe atëherë zoti Limaj këtë vendim nuk e ka marrë si kryetar i Nismës, po si nënkryetar i PDK-së. Prandaj, qëndroni korrekt në kritika dhe, ju thashë, zonja Bajrami, e di që e ke pasur të vështirë të pranosh vitin e kaluar, mandatin e kaluar, të bashkëqeverisësh me PDK-në, madje e ke pasur një prononcim që këtë e ke bërë si sakrificë për vendin, e kam parasysh dhe sakrifica të tilla uroj të mos bësh më, por le të qëndrojmë në çështjet që tani i kemi përpara.

KRYETARI: Faleminderit! Po zgjatet shumë, kanë filluar emocionet, a futemi në diskutim të pikës së rendit të ditës, ju kisha lutur, po e zgjatni tepër. Ju lutem, janë edhe 6 deputetë, asgjë s'ka të bëjë me projektligjin. Votoni për projektligj, ju kisha lutur, janë të të gjitha partive, të

shkojmë drejtpërdrejt në ligj. Vetëm po e dëmtoni njëri-tjetrin, kurrë s'po nxjerrim në dritë për projektligjin.

Ju kisha lutur, po kthehemi te projektligji.

Shkojmë, amendamenti 1. Votojmë në mënyrë elektronike.

Kush është për, kundër, abstenim? Votojmë tash!

Do të votojmë edhe një herë, në qoftë se nuk ka kuorum, atëherë edhe projektligji në tërësi nuk di pse të shkohet te i dyti pastaj. Shkojmë edhe një herë te amendamenti 1, votojmë tash!

Faleminderit! Ky është numri i votave, po kaloj nga pika e parë, s'kalojnë amendamentet e tjera kur s'kalon një amendament, mbetet kështu pezull.

## **2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj. Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, urdhëro, zoti Beqiri, për procedurë e ka.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar! Ju i keni edhe njerëzit profesionistë që e dinë këtë punë, nuk ka rëndësi a kalon një amendament a jo. Deri në fund duhet të shkojë votimi i amendamenteve dhe pastaj të nxirret ligji. Ju lutem, meqenëse e mora fjalën, vërtet për mua është e pakuptueshme pse po shkelet Rregullorja dhe në lexim të dytë po ua jepni fjalën të diskutohet. Këtu e meritojnë të diskutojnë disa dhe me marrë përgjigje që ua dhanë kolegët, por mos praktikoni kështu që mes leximesh, tash është leximi i dytë, po hapni debat, zoti kryetar. Ligji është futur në rend të ditës, ligji duhet të votohet deri në fund, a kalon a s'kalon është çështje tjetër, është vendimmarrja e Kuvendit dhe nuk mundesh pas një amendamenti ta ndalësh votimin pse s'kaloi amendamenti i parë.

Këtë derisa sot së paku s'e kam dëgjuar asnjëherë prej që jam në Kuvend. Me një amendament të ndërpritet votimi i amendamenteve të tjera, është total gabim.

KRYETARI: Faleminderit! Jo, për hir të opinionit publik, dëshiroj të qartësoj: nën një, manipulimet ndodhin nda deputetët kur e kërkojnë fjalën për çështje procedurale e pastaj futet në çështje që kanë tematikë të luftës politike. Nën një, kjo është arsyeja pse unë e jap fjalën, e pastaj arsyeja e dytë pse unë e bëj gabimin nga mirësjellja nuk ia ndali menjëherë fjalën. Në momentin që flet jashtë pikës së rendit të ditës, të dihet publik. E dyta, në çështjet të cilat kanë të bëjnë, kjo të cilën e ngriti Ismet Beqiri, kolegu deputet, t'u kisha lutur, unë asnjëherë vetëm çka mund ta dëmtojë Rregulloren për se ua jap fjalën më tepër, por kurrë proceduralisht nuk lejoj të thyhet asnjë procedurë në rregulloren e Kuvendit, as në Kushtetutë. Shikojeni me kolegë, Arbenin e

paske aty, ja ku e kam kolegun. Kisha pasur dëshirë pas gjysmë ore, një orë, ta jap edhe interpretimin. Nuk ka ndodhur asnjëherë. Nuk mundet pa kaluar një amendament të procedohet asnjë projektligj të votohet. Këtë kije parasysh. S'ka ndodhur asnjëherë sa jam unë kryetar Kuvendi, s'ka ndodhur as kur ka qenë Jakup Krasniqi, e as kur ka qenë Nexhat Daci. Të jeni të sigurt. Për hir të opinionit publik, a këtë unë po e shoh shpeshherë.

Edhe disa kolegë deputetë, është çështje tjetër e modestisë sime që lejoj në interpretim të Rregullores edhe nga ju kolegë deputetë. Por, në këtë punë e di mirë Rregulloren dhe në të njëjtën kohë e kam një administratë, e cila është shumë profesionale dhe nuk lejoj asnjëherë lëshim në asnjë sekondë. Të jeni të sigurt. Por, për këtë e shikoni, ma jepni me shkrim precedentin ku ka kaluar një projektligj kur s'ka kaluar një amendament, e marrë përgjegjësinë publikisht kërkoj falje.

## ***2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale***

Votojmë tash! Votoni, nëse doni. Faleminderit! Në bazë të rregullit, shkojmë edhe një herë. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale. Votojmë tash! Faleminderit! Nuk ka votim për shkak të mungesës së kuorumit. Nuk po e konstatoj fare në rastet kur nuk ka kuorum të mjaftueshëm, s'kam as çfarë të konstatoj në vendimmarrje kur nuk janë 61 deputetë që votojnë.

## **3. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projekt-Rregulloren dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e saj me amendamentet e propozuara. Gjithashtu, edhe tri komisionet e përhershme parlamentare e kanë shqyrtuar Projekt-Rregulloren dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e saj me amendamentet e propozuara. Do të thotë, këto tri komisionet e përhershme kanë rekomanduar miratimin e saj.

E ftoj nënkryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Hajdar Beqa për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëro, zoti Beqa!

Zonja Albulenë, Hajdar Beqa e ka fjalën. Ma kanë shkruar kështu, e bësh me shëndet këtë herë, herën tjetër, s'e kam bërë unë. Urdhëro Hajdar Beqa. Më fal, më vjen keq!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Siç e dini, Rregullorja e punës së Kuvendit ka qenë në proces të ndryshimit që dy legjislatura. Tani është legjislatura e tretë që po merret me këtë Rregullore. Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 17 tetor 2017 e ka formuar Grupin punues për hartimin e Rregullores së re, të cilën e kam kryesuar unë dhe si grup i kemi përcaktuar afatet kohore mjaft dinamike për procedimin e Rregullores për miratim në Kuvend. Grupi punues për hartimin e Rregullores së Kuvendit, duke vepruar në pajtim me vendimin e Komisionit për Legjislacion, në përbërje Hajdar Beqa, kryesues; Korab Sejdiu, Albulena Haxhiu, Shkumbin Demaliaj, Bilall Sherifi, Bahrim Shabani dhe Igor Simiq, anëtarë. Realisht te Albulena Haxhiu në grup punues e ka zëvendësuar z. Sami Kurteshi, ka qenë do të thotë pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar. Kanë mbajtur disa takime lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit. Grupi punues duke analizuar qëllimin e Projekt-Rregullores, përmbajtjen, nevojën për këtë Rregullore, rëndësinë e saj, si dhe me qëllim të rritjes së efektivitetit të normimit dhe në favor të lehtësimit të zbatimit të saj në praktikë dhe duke marrë për bazë Akgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ka hartuar Draft-Rregulloren që sot e kemi për shqyrtim.

Sot e kemi një Draft-Rregullore që e konsiderojmë shumë më të avancuar sesa Rregullorja aktuale dhe miratimi i saj do t'i arrijë tri qëllime kryesore: avancon aspektin legjislativ, avancon aspektin mbikëqyrës të Kuvendit, si dhe avancon rolin e Kuvendit në çështjen e integritetit evropian. Duke mos u ndalë në secilën risi që paraqet kjo Draft-Rregullore, po ju njoftoj se kemi arritur të përafrojmë qëndrimet, ndonëse secili grup në dispozita të caktuara, kemi edhe raste kur nuk jemi pajtuar. Çështjet që kanë qenë të diskutueshme dhe për të cilat nuk kemi pasur pajtim në përgjithësi është te neni 12, ku flitet për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Ka qenë propozim i Grupit 6+ dhe Listës serbe që zgjedhja e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve të tjera të bëhet me pako. Arsyeja që nuk është përkrahur, ka qenë se kemi vlerësuar se mund të bie ndesh me dispozitat e Kushtetutës.

Po ashtu e kemi qartësuar rolin e konferencës së kryetarëve. Është specifikuar thirrja e mbledhjeve të komisioneve, votimi në mbledhjet e komisioneve.

Po ashtu, risi është sepse kemi paraparë dy lloje të seancave dëgjimore, ato legjislative dhe mbikëqyrëse. Kemi specifikuar rolin e grupeve punuese, janë përcaktuar dispozita të qarta lidhur me zhvillimin e punimeve në Kuvend dhe masat që duhet të ndërmerren për të vendosur rend gjatë punimeve në seancat plenare të Kuvendit. Është specifikuar procedura e përshpejtuar e projektligjeve ku nuk do të ketë mundësi më të zhvillohet procedura të përshpejtuar për të gjitha rastet, por i kemi kufizuar për ata që kanë të bëjnë me sigurinë nacionale, sigurinë publike dhe shëndetin publik. Po ashtu, procedura ligjvënëse është më e qartë kur kemi të bëjmë me kërkesën e adresuar Qeverisë për të hartuar një projektligj. Po ashtu, i kemi specifikuar rastet kur projektligji nuk miratohet në Kuvend, i njëjti nuk mund të procedohet përsëri pa kaluar tre muaj.

Kemi specifikuar procesin kur kemi të bëjmë me projektligjin që kanë ardhur për plotësim-ndryshim.

Risi është edhe rasti kur i kemi lënë në diskrecion Komisionit Funkcional që pas votimit të amendamenteve të mos votohet teksti i projektligjit me amendamentet e miratuara të njëjtën ditë, me qëllim që të shmangim gabimet teknike apo kolizioneve eventuale që mund të shkaktojnë amendamentet pas shkrirjes në tekstin final. Risi është edhe një pjesë e veçantë që i dedikohet shqyrtimit të Projektligjit për Buxhet, veçmas nga komisionet parlamentare. Po ashtu, dy drafte, ky draft avancon aspektin mbikëqyrës parlamentar ku parashihen dispozitat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, raportimeve, procedurave të veçanta të raportimeve dhe mbikëqyrjes së organeve të pavarura, përfshirë zgjedhjen dhe shkarkimin në këto organe. Kurse kapitulli që ka të bëjë me avancimin e Kuvendit në aspektin e integritimeve evropiane, kemi përkrahur në tërësi amendamentet e Komisionit për Integritime Evropiane, sepse kemi konsideruar si më kompetent në këtë pjesë.

Komisioni i ka harmonizuar dispozitat e kësaj rregulloreje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, ku i kemi hequr në tërësi dispozitat që kanë të bëjnë me imunitetin, pasi që kjo pjesë nuk është zbatuar sidomos pas këtij aktgjykimi. Po ashtu, kemi harmonizuar me Ligjin në fuqi ku flitet për konfliktin e interesit, pjesë e së cilës është edhe Shtojca që ka të bëjë me Kodin e Sjelljes së deputetëve.

Andaj, deputetë të nderuar, ju lus që ta votoni secilin amendament që e ka përkrahjen e Komisionit dhe të mos e përkrahni amendamentet që nuk e kanë përkrahjen e Komisionit, sepse do ta prishni konsensusin, por edhe konsensusin që e kemi ndërtuar përgjatë kësaj kohe, derisa kemi sjell këtë draft këtu. Unë edhe një herë e sqaroj që është bërë një punë e mirë dhe të gjitha subjektet politike që kanë qenë të përfshira, grupet punuese kanë dhënë kontribut në Rregulloret e Kuvendit.

Nëse ka vullnet politik, kjo mund të kalojë sot. Normalisht që për të kaluar Rregullorja e Kuvendit duhet të ketë konsensus politik, sepse duhen 80 vota, në të kundërtën do të bëhet edhe një legjislaturë që nuk ka arritur ta miratojë Rregulloren e Kuvendit. Kjo është legjislatura e tretë, e është hera e parë që kemi arritur deri në këtë fazë. Rregullorja është si për pozitën, si për opozitën dhe kisha menduar që është në interes të Kuvendit dhe qartësimi të shumë normave të cilat edhe për sot po diskutojmë që të jetë më e lehtë për deputetët ta kuptojnë dhe për të gjithë ne të pranishmit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Kryetarja e Komisionit e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, kryetare e Komisionit!

ALBULENA HAXHIU: Së pari, për ta qartësuar! Nuk e kam fare hall a flas unë a flet Hajdari, por të paktën po përpiqemi të ju mësojmë disa rregulla. Në kohën kur kjo Rregullore është proceduar në seancë, ka qenë qershori i vitit të kaluar. Siç e dini, në shtator të vitit të kaluar, ne kemi nisur bojkot aktiv të Kuvendit dhe prandaj ka qenë çështja që është autorizuar Hajdari. Po tash janë rrethana të reja, a po më sheh që jam këtu dhe nëse unë jam këtu, ti nuk mundesh dhe nuk ke asnjë të drejtë të anashkalosh kryetarin apo kryetaren e Komisionit, në këtë rast të Komisionit për Legjislacion. Megjithatë, fare hall s'e kam, po kështu janë rregullat që i kemi rregulluar bashkë me Rregulloren e Kuvendit. Dhe, tash është e vërtetë që për të kaluar Rregullorja e Punës së Kuvendit duhet konsensus...

**KRYETARI:** Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shpeshherë në këtë Kuvend fare nuk matet fjala që del, edhe shpeshherë të tregoj të drejtën jam shumë në pozicion të rëndë nga disa fyerje të cilat, nganjëherë gjinia mashkullore mundet po duhet të kemi bre pak kulturë, kur fyen në mënyrë të paprecedent si pak më herët. Unë nuk do të ndalem. Unë do të ndalem vetëm diçka. Vetëm diçka dëshiroj për arsye se po e shoh një zor të madh, nuk e di a munden mediat ta shohin apo jo. Zakonisht Administrata e Kuvendit u referohet çdoherë dokumenteve, të cilat janë zyrtare. Unë e kam një dokument para vetes. S'e bëj me dëshirë, as nuk ia ndal fjalën kujt, përkundrazi ndoshta e teproj duke ia dhënë fjalën.

Por, kjo sjellje e paskrupullt dhe e padinjitetshme në rrethana kur ka edhe nënshkrim. Unë e kam një dokument të nënshkruar nga zonja Albulena Haxhiu si kryetare e Komisionit e cila autorizon Hajdar Beqën për të lexuar këtë raport. Unë nuk jam fajtor se çka bën Komisioni dhe çka nënshkruan. Do të thotë është dokument i cili është zyrtar. Kisha pasur dëshirë për hir të opinionit publik të gjithë të kenë sjellje më të mira, tek e fundit secili e ka për vete, mua s'më bën bash përshtypje hiç.

Jemi te amendamentet 1, 3, 5, 7, 12, 13, 14, 18, 20, 23 dhe 42. Janë propozuar nga Komisioni Funkcional. Amendamenti 1. Hajde votojmë! Sa deputetë janë në sallë? Kështu që pasi jam Kryetar i Kuvendit, edhe Rregulloren më duhet ta respektoj. Pasi nuk janë dy të tretat e Kuvendit, unë duhet ta kaloj këtë pikë të rendit të ditës, me keqardhje, për vetë faktin se nuk janë dy të tretat. Po të ishin dy të tretat e kishim respektuar Rregulloren, kishim shkuar nen për nen, por të gjithë duhet respektuar Rregulloren, edhe kryetari i Kuvendit, edhe deputetët, të gjithë.

70 deputetë janë aktualisht në sallë, veç.

Kalojmë. Jemi te pika 4 e rendit të ditës. Situatën e kemi të njëjtë.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë**

Na duhet t'i kemi dy të tretat e kësaj pjese që janë shumicë, pakicë në fakt, komunitetet, më falni për shprehje, dhe nuk mund ta procedojmë fare. Po e përmirësova, a dëgjuat, për komunitete? Kërkova falje! Po nuk kemi mundësi të arrijmë 2/3 për faktin se Lista Serbe nuk merr pjesë në seancë.

#### **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës**

Komisionet e parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, i cili nuk është këtu, zoti Naiti... Kush është në emër të Komisionit, pra në emër të Naitit dikush? Zonja Shqipe Pantina, fjala për ju!

SHQIPE PANTINA: Në fakt, edhe diskutimi për këtë projektligj ka kaluar edhe në shqyrtim të dytë, do të thotë është lexuar edhe raporti. Kështu që e gjitha që mund ta them edhe në emër të komisionit është që të votohet ligji në lexim të dytë me të gjitha amendamentet e propozuara. Faleminderit.

KRYETARI: faleminderit shumë! Zonja Ganimete... Ndërkohë Administrata po më lajmëron, ka një propozim diçka jashtë pikave të rendit të ditës. Urdhëro zonja Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

E nisëm pak me vull këtë seancë sot dhe që nga fillimi e kam kërkuar fjalën, por nuk më është dhënë mundësia që të flas.

Meqë sot është data 28 shkurt, dhe në Likoshan, Qirez, Baks e Gradicë, sot përkujtohen 24 të rënë në betejën e Likoshanit, kisha kërkuar nga ky Kuvend që më së paku me 1 minutë heshtje t'i nderojmë. Duke falënderuar gjithmonë dhe duke përkujtuar me pietetin më të lartë që falë gjakut të tyre dhe sakrificës së tyre, ne sot mund të kuvendojmë dhe thjesht të bëjmë debate, edhe ndonjëherë jo të mira as për vendin dhe as për neve.

Prandaj, kërkoj zoti kryetar që me 1 minutë heshtje t'i nderojmë të rënë e Likoshanit dhe të Qirezit.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në nderim të martirëve të rënë në betejën e Likoshanit, ju ftoj për 1 minutë heshtje. Lavdi ju qoftë!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 25 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. Procedojmë votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL.

Amendamenti 1, 68 deputetë janë të pranishëm, votojmë tash! Ndalen ju lutem! Në emër të komisionit zonja Shqipe Pantina dëshiron të shtojë diçka. Urdhëroni zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Të gjitha amendamentet në komision kanë kaluar me të gjitha votat për, kështu që propozimi ynë është që të hidhen në votim të gjitha në pako, dhe të mos shkojmë një nga një edhe për shkak të kohës. Faleminderit!

KRYETARI: Në qoftë se nuk ka reagim nga seanca, unë i vë të gjitha në pako. S'ka reagim. Atëherë do t'i vë të gjitha nga 1 deri në 25 në pako. Janë amendamente të propozuara me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Po shkojmë dhe po i votojmë në mënyrë elektronike. Kush është kundër! Prezencën i lutem administratës. Nuk ka kundër. Abstenim, a ka? Të gjithë janë për. Ta marrë prezencën. Kush është për, pra atëherë ju lutem? Prisni pak, shkojmë me elektronikë. Ju lutem! Po vetëm kur po ju pyes, ju kisha lutur që të mos e maltretojmë seancën. Reagoni në fillim, ngase unë ju pyeta. Atëherë, shkojmë në elektronikë. S'ka nevojë fare administrata, i votojmë tani të gjitha amendamentet e propozuara.

Faleminderit! Ky është numri i votave. Po nuk është mirë që të na maltretoni... Në qoftë se nuk votohet. Për arsye se në publik po flitet ndryshe... Edhe një herë shkojmë në votim, votojmë tash për 25 amendamentet e propozuara.

Jemi në proces të votimit, ju lutem!

Kalojmë në pikën e radhës, ky është votimi dhe nuk mund të shkojmë të procedojmë më tutje. Bile në rastet e kaluara është ndalur seanca aty.

Ne e kemi bërë një mundësi, por është ndalur. Unë nuk po e ndal për shkak se po ndalet e gjithë seanca. Ky është ndryshimi për korrektësi, zoti Beqiri.

***6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit***

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Zotin Ismajl Kurteshin e ftoj që ta japë raportin me rekomandime në emër të komisionit.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni i Arsimit vlerëson se Projektligji nr. 06/L-166 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit e ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara si në vijim, pra ashtu siç janë aty. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetar, a t'i vendosim amendamentet bashkë apo ndaras? Urdhëro, kryetar!

ISMAJL KURTESHI: Amendamentet të cilat i ka përkrahur komisioni, mendoj se bën të shkojnë bashkë.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, e kemi 1 amendament të propozuar në këtë projektligj. Votojmë tash për amendamentin e parë. Votojmë edhe një herë! E votojmë amendamentin tash!

65 deputetë janë në sallë, por për hir të informimit të opinionit publik, për fat të keq në këtë mandat jemi duke u ballafaquar edhe me një legjitimitet që është i deputetëve, i grupeve parlamentare të mos votohet! Po ajo që është kryesorja, për hir të korrektësisë...A do të mund ta bënim një konsultim, ngase nëse nuk ka votime, atëherë mos t'i maltretojmë deputetët dhe as opinion publik për faktin se 65 deputetë janë sallë, ndërkaq më duket që kanë qenë 77 prezent në fillim të seancë. Mirëpo ka bojkotim dhe mos ta maltretojmë vetveten!

A ka mundësi një minutë që të konsultohemi me kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit? A po dëshironi të flisni përmes publikut? Urdhëro Avdullah Hoti, po e shoh që do të reagosh.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se deputetët flasin më së miri përmes votës së tyre. Prej shtatorit e këndeje janë këto pika të cilat po sillen nga një seancë në tjetrën. Është më se e qartë se ky koalicion qeverisës nuk ka fuqi politike që t'i çojë përpara proceset politike për t'i votuar ligjet më të thjeshta.

Nuk besoj që ka nevojë... Ne nuk hezitojmë të konsultohemi, por nuk ka nevojë të konsultohemi sepse ne po flasim përmes votës këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Votë nuk ka fare për faktin se nuk po votohet. Ne po flasim që s'ka konstatim të votës fare, duhet pasur parasysh. Ka bojkot, mirëpo kjo është çështje tërësisht legjitime, unë nuk po e kontestoj. Ajo çfarë ka të bëjë me opinion publik dhe me deputetët... A ka mundësi të dihet ndonjë pikë e rendit të ditës ku dëshirohet të votohet në mënyrë që ta vë, apo vetëm të vazhdojmë kështu formalisht në mënyrë që të mos mbetet tek unë faji. Pra, të mendohet se po kalon kështu se kryetari po i vendos të njëjtat.

Për opinion publik edhe një qartësim, ngase deputetët e dinë; çdo pikë e rendit të ditës e cila nuk kalon në një seancë bartet në seancën tjetër çdoherë pavarësisht derisa t'i jepet një vendimarrje.

Në këtë rast ne nuk kemi vendimarrje për faktin se nuk po votohet fare. Nuk kemi kuorum.

Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese na vë para një situatë që në momentin kur nuk ka vendimarrje nuk konsiderohet votim fare, do të thotë është çështje në pritje dhe unë e sjelli si pikë të rendit të ditës më tepër për hir të korrektesisë, ngase e kam obligim. Kjo është.

A dëshiron dikush tjetër fjalën apo të shkojmë drejt në votim? Zonja Teuta Haxhiu, në emër të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Për t'i treguar qëndrimet e LDK-së të cilat ndryshojnë brenda ditës. Një pyetje se a është me interes të veçantë ose a është ligj me interes të veçantë projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunave? Pra, është një pyetje kur përfaqësuesit e LDK-së, dje u deklaruan që ligjet me interes të veçantë ne i votojmë.

Njëkohësisht edhe për Vetëvendosjen; a është ligj me interes të veçantë ky ligj apo jo?

Pra, maltretimet që po iu bëhen jo vetëm deputetëve që janë këtu, se në fund të fundit ne jemi vetëm individë. Por, interesat e komunave, pra është një ligj që është sjellë për herë të parë dhe që është me interes për komunat e që nënkupton për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Qëndrimi i një përfaqësuesi të LDK-së që ishte dje, i cili tha që ne çdoherë kemi votuar dhe votojmë ligje me interes të veçantë. A është ligj me interes të veçantë ky ligj apo jo? Pra, po flasim për pronat, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave.

Sado që Aleanca udhëheq 7 komuna dhe 1 që i është marr në tavolinë, por megjithatë edhe komunat e tjera dhe secila komunë nuk është në interes të subjekteve po është në interes të të gjithë qytetarëve.

Në fund të fundit, vet propozimet kanë qenë edhe prej një kryetari të LDK-së atje në Podujevë, Agim Veliut. Pra, që është edhe kryetar i Asociacionit të Komunave. Pra, shikoni se çfarë flasin sot dhe nuk dinë se çka mendojnë nesër, pra janë të çorientuar ngase i kanë zgjedhjet e brendshme dhe s'po di kush po bëhet kryetar i LDK-së, sinqerisht.

KRYETARI: Glauk Konjufca në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje! Më fal të lutem Glauk! A ta përmendi emrin se isha duke u marrë me dokumente? Urdhëro zotëri Hoti, replikë!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Është interes madhor që sa më parë të ndërrohet ky model i qeverisjes. Ky është interesi kryesor dhe angazhimi kryesor politik i yni gjatë gjithë kësaj periudhe. Vetëm këtë desha t'ia them deputetes në fjalë.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendi, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Pra, replikë po nuk është këtu kryetari i Podujevës, Agim Veliu, të cilit ia përmenda emrin dhe i cili në emër të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës ka kërkuar që ky projektligj të kalojë ngase iu jep mundësi për investime në komuna.

Pra, ju po i ndalni investitorët që të vijnë në komuna. Pra, a është interes ky apo nuk është? A është ligj me interes të veçantë apo nuk është? Sikurse e tha mbrëmë një koleg i juaji në debat televiziv.

Pra, edhe njëherë po flas për kryetarin Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës që bashkë me komisionin e kanë sjellë këtë projektligj dhe kanë kërkuar që ky projektligj të kalojë.

Ndërkaq ju po ndalni interesin e komunave që i bie interesin e secilit qytetar të Republikës së Kosovës. Pra, shkresat janë, nëse kjo nuk është e vërtetë është mirë që të na e thotë shefi apo kushdo i LDK-së që është kundër...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFGA: Mendoj që ky shpjegim i zonjës Haxhiu është një propagandë e pajustificueshme, për shkak që pas kësaj që e tha, logjikisht i bie që për shkak të kësaj nuk kanë mundur të ndodhin investime nëpër komuna, kjo nuk është e vërtetë. Investimet nëpër komuna kanë ndodhur gjithë, varet prej mënyrës së qeverisjes aty dhe aftësive të njerëzve, të kryetarëve të komunave dhe ekipeve të tyre për të mbledhur donacione dhe për të hapur rrugë për investime, gjë që unë mendoj që nuk ka qenë pengesë e ligjeve deri tash në Kosovë.

Mendoj që pengesa kryesore e investimeve në Kosovë deri tash ka qenë korrupsioni, edhe për këtë kanë dalë fakte të bollshme gjatë viteve të kaluara, kush i ka ndaluar investimet e huaja në Kosovë, kush u ka kërkuar para me përqindje investitorëve të caktuar, dhe pse janë ndaluar këto investime, pse investimet e huaja direkte në Kosovë përgjatë viteve kanë shkuar duke u ulur vazhdimisht.

Pra, ky është thjesht një arsyetim koti dhe pa kurrfarë argumenti racional, për arsye se kjo i bie që po të mos bëhet kjo, asnjë investim në asnjë komunë të Kosovës nuk do të ndodhë, kjo është një gënjeshtëri. Investimet do të ndodhin, mirëpo kjo është vetëm një lehtësim shtesë formal për investimet në Kosovë.

Mirëpo, kur është te interesi madhor i veçantë, meqenëse jemi te ligji i veçantë edhe çka është e veçantë, unë mendoj që interesi i veçantë i qytetarëve të Kosovës është të mos e shohin më këtë Qeveri të papërgjegjshme në krye të Kosovës. Këto të tjerat pastaj rregullohen, pas të rregullohet kjo çështja kryesore, kjo e veçanta kryesore.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit për mundësinë e dhënë sërish.

Pra, edhe një herë, a është me interes të veçantë edhe për kryetarin e Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka ka kërkuar që ky projektligj të kalojë, a është me interes të veçantë edhe për Vetëvendosjen, demagogjinë e llojit të vet që e ka edhe Glauku, nuk është risi për ne. Por, a është mundësi për komunat që të kenë lehtësi që investitorët të vijnë në komuna të investojnë, kjo është një pikëpyetje që edhe një qytetar i thjeshtë e kupton, po ndryshe mund ta kuptojë Glauku.

Pra, kërkesa e kryetarit të Prizrenit, bashkë me kryetarin e Asociacionit të komunave, të gjithë së bashku kanë kërkuar që ky projektligj të kalojë, nga se është me interes për komunat. Po e përmend vetëm një rast, në komunën e Fushë- Kosovës nuk ka prona që të ndërtohet një objekt shkollor, komuna nuk ka asnjë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së, por, ta sqaroj, më herët fola në emër të komisionit, sepse kryetari nuk ishte këtu dhe si nënkryetare e arsyetova raportin. Tani po flas në emër të grupit parlamentar.

Debatet për përmbajtjen e ligjit mendoj se kanë përfunduar dhe në bazë të procedurës, ato bëhen kryesisht në leximin e parë.

Megjithatë, ju lus edhe kolegët që kur të flasin për përmbajtjen, të flasin të bazuar, sepse po të mos kishte nevojë dhe po ta kishin mundësinë komunat që të thithnin investime, nuk do të kishte nevojë për plotësim-ndryshimin e këtij ligjit.

Pra, kërkesa për ndryshim ka ardhur nga Asociacioni i komunave të Kosovës, të gjitha propozimet nga asociacioni kanë ardhur të miratuara unanimisht nga të gjithë kryetarët, ashtu siç ka ndodhur edhe me amendamentet që i ka miratuar komisioni, të cilat po ashtu janë votuar unanimisht. Pra, të gjitha grupet parlamentare i kanë votuar të gjitha propozimet për amendamentet që vijnë nga komisioni.

Prandaj, unë edhe një herë ju lus që ta miratojmë projektligjin, sepse është një lehtësim shumë i madh për të gjitha komunat e Kosovës, për më tepër u mundëson atyre që disa prona që deri më tani janë menaxhuar nga AKP-ja, nga Agjencia për Privatizim, tani t'i marrin komunat nën menaxhim dhe me to të mundësojnë investimet që vijnë edhe nga jashtë. Faleminderit!

Pra, ju kërkoj që ta votoni projektligjin.

KRYESUESI: Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegë deputetë,

Kabinetin qeveritar,

Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave, Komisioni e ka shqyrtuar, ka bërë amendamentet në bazë të kërkesave të Asociacionit të komunave dhe kryetarëve të komunave që ka pasur debat publik me ta dhe interesi i të gjithë kryetarëve të komunave është pikërisht t'u mundësohet të jenë më të drejtpërdrejtë dhe më të angazhuar pikërisht në çështjen e pronës së komunës.

Me këtë projektligj edhe me amendamentet që janë bërë u është dhënë mundësi kryetarëve të komunës të jenë të pranishëm drejtpërdrejt gjatë procesit, ku edhe të hynë në pjesën e negociimit drejtpërdrejt për çështjet e pronës së komunës...

KRYESUESI: Nait, e kemi kaluar këtë pikë, mos u merr tash me të...

NAIT HASANI: Ne kemi kërkuar bashkë, e kemi miratuar, prandaj po kërkoj që deputetët të marrin pjesë në votim, ta votojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Jemi në pikën e gjashtë të rendit të ditës. U diskutua, e hedh në votim amendamentin 1, votojmë tash dhe pastaj e votojmë ligjin në tërësi, në qoftë se miratohet.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-090 për sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit**

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash amendamentin e vetëm.  
Amendamenti 1. Nuk ka kuorum.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/24, Ligji i sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/24 për sport**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Kurteshi, për arsyetimin e raportit të komisionit.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar ligjin që e përmendët dhe i rekomandon Kuvendit që ta votojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

Ky projektligj i ka tri amendamente.  
Fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1  
Votojmë tash!  
Nuk kalon.

Atëherë e kalojmë ligjin në tërësi për seancën e radhës.

Amendamentin 2, nëse doni, vazhdojmë ta votojmë. A doni ta votoni? T'i thyejmë rregullat e përparshme.

## **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Kurteshi, për arsyetimin e raportit të Komisionit. Faleminderit! Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe këtë projektligj komisioni e ka shqyrtuar dhe i rekomandon Kuvendit që ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe unë ju kisha lutur që t'i votoni amendamentet dhe ligjin, për shkak se bëhet fjalë për rininë.

Kemi dy amendamente. Fillojmë me votimin.

Amendamenti 1

Votojmë tani!

Nuk kalon, nuk ka vullnet për t'u kaluar as ky amendament.

Në sallë janë 70 deputetë.

## **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit të komisionit.

Zoti Naser Osmani, në vend të Lumirit.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe ka propozuar amendamentet, me të cilat janë bërë ndryshime dhe plotësime të nevojshme përmbajtjesore, gjuhësore dhe të harmonizimit dhe terminologjinë juridike dhe legjislacionit në fuqi.

Komisioni ka propozuar gjithsej 25 amendamente dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjeve me amendamentet e propozuara.

Komisioni ka shqyrtuar edhe amendamentet e propozuara nga deputetët Shqipe Pantina dhe Bekim Haxhiu dhe të njëjtat nuk i ka përkrahur.

Më lejoni të jap vetëm një sqarim, pse nuk është përkrahur sidomos amendamenti i Bekim Haxhiut dhe pse është përkrahur amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Me projektligjin e propozuar nga Qeveria është paraparë mundësia e zbritjes nga tatimi në të ardhurat personale dhe të korporatave për persona që kontribuojnë në formë të donacioneve dhe sponsorimeve për qëllime humanitare shëndetësore, edukative, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive deri në 10% si dhe një zbritje shtesë prej 10% nëse parashihet me ligj të veçantë për këto qëllime.

Komisioni, përmes amendamentit 17 ka propozuar që zbritja shtesë për qëllime të sponsorimit të jetë 20% dhe në total zbritja e lejuar për sponsorime, donacione të lejohet deri në 30%.

Me këtë propozim që e ka bërë komisioni është bërë e mundur të njihen shpenzimet deri në 30, njëjtë ashtu siç ka kërkuar me amendament edhe deputeti Bekim Haxhiu.

Mirëpo, për shkak se ligjet tatimore janë ligje speciale për tatime, ku janë të përcaktuar kriteret dhe kushtet në bazë të cilave lejohen dhe pranohen zbritjet nga tatime në të ardhura për shpenzime dhe kontribute të caktuara, ndërsa ligji për sponsorime nuk e parasheh kriterin për zbritjen e sponsorimeve.

Një ndryshim tjetër esencial, është bërë ndryshimi i komisionit që e rregullon amendamentin që ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve të zbritshme për provizionet për humbjet e pritura nga kreditë e bankave, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, ka të bëjë kryesisht me industrinë e sigurimeve që të jetë deri në 80% të shumës së përcaktuar me akte nënligjore, të cilat i nxjerr Banka Qendrore e Kosovës.

I përmenda vetëm dy më të rëndësishmet, më specifike, ndërsa amendamentet e tjera janë bërë kryesisht për atë që ka të bëjë më tepër me rregullime teknike, gjuhësore dhe përshtatjen e gjuhës juridike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu do ta sqarojë propozim amendamentin e tij dhe Shqipe Pantina, po ashtu. Zoti Haxhiu, e keni fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më shumë e mora fjalën për të shprehur qëndrimin e shumë sportistëve dhe të atyre që presin që Ligji për sponsorizime të jetësohet, një ligj që ky Parlament e ka votuar vite më parë, pothuajse

një vit e gjysmë prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk po gjen zbatimin për shkak se nuk ka qenë i harmonizuar me Ligjin për tatimin në të ardhura korporata dhe në të ardhura personale. Pra, është një mundësi e mirë që Parlamenti i Republikës së Kosovës të orientojë votën e tij kah sporti, kah rinia dhe kultura dhe atë mund ta bëjë me votën e tyre, se a do të votohet amendamenti im apo i Komisionit FunkSIONAL, mendoj që edhe njëra, edhe tjetra do të jenë në shfrytëzim dhe në qëllim të mbështetjes për sportin, prandaj po kërkoj vetëm vëmendjen tuaj që të merrni pjesë në votim dhe të mos prolongohet edhe më tutje moszbatimi i Ligjit për sponsorizime, sepse donatorët, sportistët dhe bota e kulturës dhe e rinisë po e presin një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e keni fjalën.

SHQIPE PANTINA: Po, faleminderit kryesues! Vetëm për t'i njoftuar më mirë edhe deputetët e tjerë që s'janë anëtarë të Komisionit për Buxhet se çka ka të bëjë amendamenti që unë e kam propozuar.

Kërkesa ime ka qenë që të gjithë prindërit, e këtu numri më i madh i tyre janë nëna, që bëjnë të vetme barrën e kujdesit të familjes, për arsye se kanë humbur bashkëshortin, e këto të lirohen nga tatimi në të ardhura personale. Është krejt ndryshe kur janë të dy bashkëshortët, ndonëse njëri nuk punon, ai që nuk punon mund të kujdeset për fëmijët, përderisa prindi tjetër është në punë, por për prindërit që janë të vetëm gjithmonë duhet ose kanë shpenzime shtesë, sepse ose duhet t'i çojnë patjetër në çerdhe, ose të paguajnë një kujdestare për t'u kujdesur për fëmijët gjatë orarit tyre të punës. Unë mendoj se ky numër i prindërve nuk është aq i madh, ndonëse as lehtësia që u mundësohet atyre nga lirimi në të ardhura personale nuk është ndonjë ndihmë e madhe, megjithatë sadopak u ndihmon, për më tepër kjo është praktikë pothuajse në të gjitha vendet e BE-së. Prandaj, unë kisha kërkuar nga të gjithë deputetët dhe, në veçanti nga koleget e mia deputete që ta përkrahin amendamentin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, i hedh në votim të gjitha amendamentet që janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, përjashtuar amendamentin 7 dhe 16, të cilët do të votohen veç e veç.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Dhe, për pikën e 9-të të rendit të ditës vlen e njëjta situatë. Nuk ka kuorum.

## **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave**

Unë mendoj që çështje kryesore e kësaj Rregulloreje që e keni përgatitur do të ishte që të vendoset rregulla që ligjet që nuk miratohen, vendimet që nuk miratohen të mos kenë të drejtë të

kthehen në Parlament para 6 muajsh. Kjo duhet të jetë vendim politik dhe organizativ i këtij Parlamenti dhe jo të barten nga seanca në seancë të njëjtat çështje.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e komisionit, zotin Abdixhiku, që ta paraqesë raportin e komisionit, ose zoti Osmani.

NASER OSMANI: E njëjta gjë, zoti kryetar, sikur për Ligjin për tatimin në të ardhura personale, është edhe për Ligjin në korporata. Domethënë, se të njëjtat, dy amendamente për të cilat diskutova, kanë të bëjnë edhe me korporatat, vetëm që tash kemi të bëjmë me ndryshime për 25 amendamentet, të cilat kërkojmë që të përkrahen ato të Komisionit FunkSIONAL, respektivisht Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi të propozuara 24 amendamente të Komisionit FunkSIONAL dhe 1 amendament të propozuar nga zoti Haxhiu. I hedh në votim amendamentet nga i pari deri te i 25-i, duke përjashtuar amendamentin 5 të zotit Haxhiu.

Janë të gjitha amendamente të Komisionit FunkSIONAL, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Faleminderit! Është e njëjta situatë, prapë e shtyjmë për seancat e tjera.

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Kurteshi, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Arsim e ka vlerësuar Projektligjin Nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 dhe ka konstatuar se ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e projekt amendamenteve të propozuara. Pra, janë 19 projekt amendamente, komisioni e ka përkrahur këtë projektligj me unanimitet dhe ka punuar jashtëzakonisht gjatë në këtë projektligj, është konsultuar me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe me disa faktorë relevantë ndërkombëtarë, ka ardhur në përfundim se ky projektligj duhet të votohet për shkak të rëndësisë së veçantë të këtij ligji dhe kontributit të madh që punëtorët e arsimit e kanë dhënë në periudhën për të cilën ka të bëjë ky projektligj.

I lus deputetët që ta votojnë këtë projektligj, i cili edhe ashtu është përkrahur unanimitet nga Komisioni Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, po vazhdojmë me votimin e amendamenteve të Komisionit Funkcional që janë gjithsej 19 amendamente. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Atëherë konstatoj që kanë kaluar të 19 amendamentet me 68 vota për, 2 abstenime.

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 71 deputetë. 71 deputetë janë për.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës nga viti '90/'91 deri në vitin shkollor '98/'99. Urime të gjithëve!

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj anëtarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zonjën Albulena Haxhiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Zoti Beqa, a e ke ti fjalën, a Albulena?

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11. 12. 2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës me amendamentet e propozuara nga komisioni dhe vendosi Kuvendit t'i paraqesë raportin dhe i rekomandon të votojë këtë projektligj.

Ne kemi mbështetur në komision të gjitha subjektet politike, u bë një punë e mirë mes dy komisioneve nga Grupi Punues dhe Komisioni për Legjislacion dhe i ftoj deputetët që ta përkrahin. Do të thotë, nuk kemi amendamente që nuk janë të përkrahur nga komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Po fillojmë atëherë me votimin e amendamenteve. Në projektligj janë 33 amendamente nga Komisioni Funkcional dhe 12 amendamente nga deputetët.

Amendamenti 2, 5, 7, 11, 12, 14, 17, 19, 22, 26 dhe 27, procedojmë me votimin e amendamenteve tani.

Amendamenti 1. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon, nuk kemi gatishmëri të deputetëve për të marrë pjesë në votim.

### **13. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar për kryetar dhe anëtar të komisionit deputetët Lirije Kajtazi, kryetare, Armend Zemaj anëtar. Grupi i PDK-së ka propozuar për anëtarë të komisionit deputetët Blerta Deliu Kodra dhe Bekim Haxhiu, anëtar. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar për anëtarë të komisionit deputetët Valon Ramadani, anëtar dhe Adem Mikullovcit anëtar. Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar për zëvendëskryetar të parë të komisionit deputetin Rasim Selmanaj. Grupi Parlamentar i PSD-së ka propozuar për anëtar të komisionit deputeten Shqipe Pantina. Lista serbe nuk ka propozuar kandidat. Grupi Parlamentar Nisma ka propozuar për anëtar të komisionit deputetin Zafir Berisha. Grupi Parlamentar 6+ ka propozuar për anëtar të komisionit deputetin Albert Kinolli.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Zonja Haxhiu e ka fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit! Vetëm një sqarim, nga Lëvizja Vetëvendosje është e vërtetë që janë propozuar deputeti Valon Ramadani dhe po ashtu deputeti Adem Mikullovcit, por për shkak të disa rrethanave, ne në vend të deputetit Adem Mikullovcit, propozojmë deputetin Sali Zyba.

KRYESUESI: Atëherë kemi vetëm një ndryshim. Në vend të deputetit Adem Mikullovcit vjen deputeti Sali Zyba në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, pra. A po do edhe Memli, a? Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ditën kur e kemi diskutuar herën e parë formimin e Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancë unë i ka propozuar dy kandidatë, por që ka pasur edhe një Komision tjetër dhe i kam propozuar kandidatët që kanë qenë për Komisionin hetimor për Valë dhe për PTK, andaj kisha kërkuar mirëkuptim për të bërë një ndryshim dhe t'i propozojmë kandidatët në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së do t'i çojmë në këtë komision ad hoc dhe përfaqësuesit tonë në këtë komision do të jenë Safete Hadërgjonaj dhe Xhevahire Izmaqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë edhe te Grupi Parlamentar kemi ndryshim në kandidatët. Pra, janë të propozuara Safete Hadërgjonaj dhe Xhevhire Izmaku. A ka dikush tjetër ndonjë diskutim sa i përket kësaj çështjeje? Nuk ka. Ju lus që t'i zini vendet të nderuar deputetë. Është koha për të votuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

E përsëris edhe një herë votimin. Shpresoj që për kandidatët e juaj do të votoni të gjitha grupet parlamentare. E përsëris votimin, janë 67 deputetë në sallë, lus regjinë dhe deputetët t'i zënë vendet për votim dhe fillojmë me votimin. Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj se në Kuvend kanë votuar 63 deputetë. 62 janë për, 1 abstenim.

Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 10 të Ligjit 06/L-048 për Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i paraqes raportin me rekomandime.

#### **14. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017**

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon. D.mth. nuk voton kuorumi.

#### **15. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,**

Procedojmë me votimin e raportit. Regjia dhe ju deputetë të përgatiteni për votim. Votojmë tani! Faleminderit! Nuk kalon as kjo.

**16. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi**

Procedojmë me votimin e raportit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

E njëjta situatë edhe për pikën 16.

**17. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017**

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon.

**18. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017**

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon as ky. Faleminderit!

**19. Emërimi i 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor**

Procedojmë me votimin dhe emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për trashëgimi Kulturor, në këtë përbërje të propozuar: Zanita Halimi, Premtim Alaj, Arjeta Miftari, Arsim Mehmeti, Muhamet Qerimi, Bego Kululleri dhe Filko Jovanoviq.

Lus regjinë dhe deputetët... A ka diskutime për këtë punë? Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Ne votuam për një varg raportesh si Kuvend i Kosovës, edhe thjesht nuk po e kuptoj.

KRYESUESI: Për pikën fjalën, mos na mbaj tani.

FATON TOPALLI: Jo shumë shkurt.

KRYESUESI: Jo, jo, hiç, veç për pikën në fjalë.

FATON TOPALLI: Nuk po e kuptoj logjikën, në qoftë se kemi kërkuar nga institucionet...

KRYESUESI: Ndale! Stop! Mos na jep mësim neve. Ne jemi të gjithë njësoj si ti. As mos e merreni heroizmin personalisht për votim, as. Ne po rrimë në sallë, dikush voton, dikush nuk voton dhe s'ka nevojë as të fyejmë njëri-tjetrin.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Nuk kalon.

20. Shkarkimi i një (1) anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare,

Procedojmë me votimin për shkarkimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare, Shqiprim Pula sipas rekomandimit të Komisionit FunkSIONAL.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Votojmë tani!

## **21. Zgjedhja e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë**

Procedojmë me zgjedhjen e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Ju njoftoj se në bazë të Ligjit 05/L-84, Rregullorja e Energjisë, kryesuesi dhe anëtar i Bordit të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për pozitën e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Qeveria ka propozuar kandidatë si në vijim: Bekim Jakupi, Petrit Pepaj, Fadil Ismajli, Përparim Kabashi. Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një komisioni votues në përbërje të një deputeti prej secili grup parlamentar.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komision votues. Njëkohësisht mendoj që krahas propozimit do të ishte mirë që të kemi edhe qëndrimin e grupeve, a do të marrin pjesë në votim, sepse nëse nuk marrin pjesë në votim, nuk kalon dhe humbim kohë duke votuar me kuti.

Atëherë fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Grupi i LDK-së cakton deputetin Driton Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së?

MEMLI KRASNIQI: Ne e propozojmë deputetin Hajdar Beqa në këtë komision nëse veç edhe ka vullnet të votohet kjo farë pune.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. Glauk, a doni të propozoni? Në komision a doni të propozoni dikë, apo jo?

GLAUK KONJUFCA: Për cilin, a mund të më tregosh?

KRYESUESI: Zgjedhja e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Janë të propozuar kandidatët, katër kandidatë dhe ne kemi për të bërë votim të fshehtë.

GLAUK KONJUFCA: A të krijohet ai Komisioni? Ok. Pra, Salih Zybën e propozojmë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së, kë e propozon?

AHMET ISUFI: Zoti Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj. Grupi Parlamentar i PSD-së?

SHQIPE PANTINA: Ne e propozojmë z. Driton Çaushi, por nëse ka mundësi kryesues të bëjmë edhe një propozim tjetër. Janë diku katër pika të rendit të ditës të cilat do të kërkojnë votim të fshehtë. A ka mundësi t'i bëjmë të gjitha bashkë. I bëjmë katër kuti votimi, edhe i kryejmë përnjëherë?

KRYESUESI: Për mua bën, nuk kam ndonjë vërejtje, a jeni dakord ju të qëndroni dhe të votoni? I bëjmë atëherë, pse jo? Atëherë, edhe LDK-ja. S'ka kuti a, po e marrim nga një gajbe diku atje. Ato janë me ngjyra fletat ndryshe. Në rregull i bëjmë me kuti, dy me dy a po? Komisionet po i lëmë të njëjta, ndërsa votimet i bëjmë dy herë se po mungojnë kutitë. Kuvendi i Kosovës me tri kuti!

Mbeti të propozojë Grupi Parlamentar i PSD-së, propozove. Faleminderit!

Lista serbe, nuk është këtu.

Grupi Parlamentar Nisma, kë e propozon?

ENVER HOTI: Nisma Socialdemokrate e propozon Veton Berishën.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Grupi Parlamentar 6+?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!  
Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Bahrim Shabani.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, ju lus që t'i sillni tri kutia, edhe pastaj ia bëjmë diqysh me të katërtën. Fillojmë me votimin, varet nga administrata sa janë përgatitur.

Atëherë, dua t'ju njoftoj që te Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me shkresë ka kërkuar zoti Fadil Ismajli që të mos jetë në listën e të votuarve, ka shkuar diku tjetër me punë. Kështu që kemi vetëm tri kandidatura, duke përjashtuar, mirë, unë po ju them çka po më thotë sekretari, sipas procedurës, ne i kemi katër anëtarë, katër kandidatë, për mua votoni kë të doni, njësoj.

\* \* \*

E lus komisionin të zërë vendet, besoj që nuk ka vërejtje. Kontrolloni atë paketë, a ka gjë brenda, sepse kemi një përpjekje. Në rregull jemi, vetëm kontrolloni si komision të mos dyshohet se kanë futur diçka dikush brenda dhe le ta shohin edhe këta, se ne pritëm mos po e sjellin një tjetër kuti.

Komisioni t'i zërë vendet e veta, Myfera, votoni të parët ju që duhet të shkoni.

Lus komisionin që zoti Damka dhe zonjës Shinik t'u mundësohet të votojnë të parët, se kanë një punë.

Atëherë ju thërras me radhë:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albert Kinolli, Albin Kurti, Albulena Balaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Andin Hoti, Anton Çuni, Arban Abrashi, Kadri Veseli, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Arben Gashi, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu - Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaç - Bujup, Doruntinë Maloku - Kastrati, Drita Millaku, Driton Çaushi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi - Dragusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekaliu, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli - Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj - Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Mufëra Srbica - Shinik, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku - Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari - Lila, Mirjeta Kalludra, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Sasha Milosavljeviq, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha - Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Srdjan Mitroviq, Shëmsi Sylja, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku -

Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Ceraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani - Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaqu, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviq.

A ka dikush që s'ka votuar? Nëse ka, le të vijë te qendra e votimit, krejt janë në rregull. Ju lus që të filloni me procedurat.

\* \* \*

KRYESUESI: Atëherë, regjia fjalën Komisionit. Sipas renditjes, bëje raportimin!

RASIM SELMANAJ: Fillojmë me numërimin për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë:

Përparim Kabashi,  
Bekim Jakupi,  
